

AKT - THEMELIMI

I



SHOQERISE ANONIME "ABISSNET" SH.A.

Ne Tirane sot ne daten 29/10/1999, zoti **Koço Kokedhima**, shtetas shqiptar, banues ne Tirane, si themelues i kesaj Shoqerie anonime, ne te cilen ai eshte aksioner i vetem. vendosi te hartoje kete **Akt Themelimi**, mbeshtetur ne parimet e meposhteme:

Neni 1

Themeluesi krijon nje shoqeri anonime te cilen do ta quaje "ABISSNET" sh.a. Shoqeria do te jete e tipit sh.a. pa oferte publike per aq kohe sa Asambleja nuk do te marre nje vendim per shnderrimin e saj ne shoqeri anonime me oferte publike ose ne çdo forme tjeter shoqerie te parashikuar nga ligji Nr. 7638, date 19/11/1992 "Per Shoqerite Tregtare".

Neni 2

Emertimi i plote i shoqerise eshte "Albanian Business Information System & Service Network".
Emertimi i shkurtuar i shoqerise eshte "ABISSNET".

Neni 3

Selia e shoqerise eshte ne adresen: Rruga "Vaso Pasha", Nr. 71/1, (prane BKT Nr. 2) Tirane. Ajo mund te transferohet ne çdo vend tjeter me nje vendim te Keshillit Mbikqyres, me kusht qe ky vendim te miratohet nga mbledhja me e afert e Asamblese se Aksionereve. ne rastin e transferimit te shoqerise me vendim te Keshillit Mbikqyres. ky i fundit eshte i autorizuar te beje ndryshimet e nevojshme ne statutin e shoqerise..

Neni 4

Kohezgjatja e shoqerise do te jete per nje periudhe te pacaktuar te veprimtarise se saj, por sidoqofte mbi 10 vjet, duke filluar qe nga momenti i rregjistrimit te saj ne Rregjistrin Tregetar, me perjashtim te rasteve kur shoqeria mbaron sipas parashikimeve ne ligj ose kur vendos Asambleja e Aksionereve.

Neni 5

Objekti i shoqerise "ABISSNET" sh.a. eshte:

Kryerja e sherbimeve te nderlidhjes ne internet, e-mail, Web Hosting etj, te abonenave te ndryshem. Video-konferencat, mesimi ne distance, radiokomunikimi etj. Studimin, projektimin dhe sipermarrjen ne fushen e komunikacionit, programimit dhe informatizimit. Zhvillimi i teknologjive te informacionit, projektimi dhe ekzekutimi e rrjeteve dhe minirrjeteve, zhvillimi i testeve, publicitetit etj. Zhvillimi i sherbimeve dhe teknologjive per mbledhjen permiresimin dhe transferimin e te dhenave etj. Importimi dhe shitblerja e paisjeve elektronike dhe elektrike, kancelarive etj. Brenda kuadrit te dispozitave te ligjit nr. 8038, date 23/ 1/1995 si dhe te ligjit Nr. 8287, date 18/02/1998 "Per disa ndryshime ne ligjin Nr. 8038. date 23/11/1995" shoqeria do te kryeje çdo biznes te pershtatshem per arritjen e qellimit te saj. Kjo perfshin krijimin e filialeve te reja, shtimin e numrit te abonenteve ne nje faze te pershtatshme ne rast te zgjerimit te veprimtarise se saj. Pjesemarrja ne kapitalin e shoqerive te tjera, brenda dhe jashte vendit.

Neni 6

Shoqeria ka per qellim:

- Te çele fronte te reja pune
- Te emancipoje opinionin publik dhe zyrtar
- Te realizoje fitim nga aktiviteti.

Neni 7

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 3 200 000 leke. Ky kapital eshte i vlefshem per regjistrimin e shoqerise.


Kapitali realizohet ne perputhje me perqindjet reciproke te pjesemarrjes se aksionereve ne shoqeri menjehere me nenshkrimin e kontrates. Ky kapital eshte i ndare ne aksione me vlere nominale 1 000 leke secili. Ne kete menyre kapitali themeltar i "ABISSNET" sh.a. perbehet nga 3 200 aksione te numeruara nga 1 (nje) deri ne 3 200 aksione perfshi çdo numrin e fundit, te zoteruara teresisht nga aksioneri i vetem z.Koço Kokedhima.

Neni 8

Keshilli i pare mbikqyres perbehet nga:

- 1) Albana Plaku
- 2) Ina Aleks
- 3) Arjan Beta

Eksperti i pare kontabel i autorizuar eshte Ethem Sula.






Neni 9


Ndertimi, organizimi dhe funksionimi i shoqerise rregullohet sipas dispozitave te legjislacionit shqiptar si dhe ne baze te statutit dhe ketij akti themelimi.

Neni 10

Shoqeria anonime "ABISSNET" fillon veprimtarine e saj me nenshkrimin dhe miratimin e dokumentave te saj themeluese.

Themeluesi


Koço Kokedhima



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE



Nr. 118 Rep.

Nr. 18 Kol.

VERTETIM

Ne Tirane, sot me date 29/10/1999, ne zyren e noterise Tirane, para meje Noteres Aferdita Haxhia me adrese ne rrugen "Zhan D'Ark", prane Gjykates se Rrethit Tirane, u paraqit personalisht z.Koco Kokedhima i biri i Theodhoriut, i datelindjes 21.04.1959 me banim ne Tirane, me shtetesi dhe kombesi shqiptare, me pasaporte Nr.0183354, madho-, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i cili nenshkroi me vullnetin e tij te lire dhe te plote Aktin e Themelimit te Shoqerise Anonime "ABISSNET" sh.a. dhe une noterja vertetoi nenshkrimin e tij rregullisht sipas ligjit.

NOTERE

STATUTI I SHOQERISE "ABISSNET" SH.A.



KREU I

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1

KRIJIMI I SHOQERISE

Shoqeria anonime me emertimin "ABISSNET" sh.a. krijohet ne baze te aktit te themelimit date 29/10/1999.nga aksioneri i vetem z.Koço Kokedhima

Neni 2

FORMA E SHOQERISE

Shoqeria do te kete formen e shoqerise anonime pa oferte publike, per sa kohe qe Asambleja e Aksionereve nuk do te marre nje vendim per shnderrimin e saj ne nje shoqeri anonime me oferte publike ose ne ndonje forme tjeter shoqerie te parashikuar nga ligji 7638 date 19/11/1992 "Per Shoqerite Tregetare".

Veprimtaria e shoqerise do te rregullohet nga dispozitat perkatese te ligjit Nr. 7638 date 19/11/1992 "Per Shoqerite Tregetare" si dhe nga ky statut dhe nga legjislacioni ne fuqi.

Neni 3

PERSONALITETI JURIDIK

Kjo shoqeri fiton personalitetin juridik me rregjistrimin e saj ne Rregjistrin Tregetar te Gjykates se Rrethit Tirane.

Neni 4

EMERTIMI I SHOQERISE

Emertimi i plote i shoqerise eshte "Albanian Business Information System & Service Network".

Emertimi i shkurtuar i shoqërisë është "ABISSNET".

Ne të gjitha aktet dhe dokumentet e nxjerra nga shoqëria emertimi i shoqërisë do të ndiqet nga fjalet "Shoqëri Anonime" ose inçialet sh.a. duke treguar dhe shumën e kapitalit themeltar.



Neni 5

SELIA

Selia e shoqërisë është në adresën: Rruga "Vaso Pasha", Nr. 71/1, (pranë BKT Nr. 2) Tiranë. Ajo mund të transferohet në çdo vend tjetër me një vendim të Keshillit Mbikqyres, me kusht që ky vendim të miratohet nga mbledhja me e afert e Asamblese së Aksionereve në rastin e transferimit të shoqërisë me vendim të Keshillit Mbikqyres, ky i fundit është i autorizuar të bëjë ndryshimet e nevojshme në statutin e shoqërisë..

Neni 6

OBJEKTI

Objekti i shoqërisë "ABISSNET" sh.a. është:
Kryerjen e shërbimeve të nderlidhjes në internet, e-mail, Web Hosting etj, të abonenteve të ndryshëm. Video-konferencat, mesazhin në distancë, radiokomunikimi etj. Studimin, projektimin dhe sipërmarrjen në fushën e komunikacionit, programimit dhe informatizimit. Zhvillimi i teknologjive të informacionit, projektimi dhe ekzekutimi i rrjeteve dhe minirrjeteve, zhvillimi i tësëve, publicitetit etj. Zhvillimi i shërbimeve dhe teknologjive për mbledhjen përmesimit dhe transferimin e të dhenave etj. Importimi dhe shitblerja e pajisjeve elektronike dhe elektrike, kancelarive etj. Brenda kuadrantit të dispozitave të ligjit nr. 8038, datë 23/11/1995 si dhe të ligjit Nr. 8287, datë 18/02/1998 "Për disa ndryshime në ligjin Nr. 8038, datë 23/11/1995" shoqëria do të kryejë çdo biznes të përshtatshëm për arritjen e qëllimit të saj, kjo përfshin krijimin e filialeve të reja, shtimin e numrit të abonentëve në një fazë të përshtatshme në rast të zgjerimit të veprimtarisë së saj. Pjesëmarrja në kapitalin e shoqërive të tjera, brenda dhe jashtë vendit.

Neni 7

KOHEZGJATJA

Shoqëria ka një kohezgjatje të pacaktuar të veprimtarisë së saj, por sidoqoftë mbi 10 vjet, duke filluar që nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregëtar. Ajo mund të përfundojë veprimtarinë e saj në çdo kohë me vendim të Asamblese së Jashtëzakonshme të aksionereve ose sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Shoqëria pushon veprimtarinë e saj si shoqëri anonime pa oferte publike sipas nenit 75 të ligjit 7638 datë 19/11/1992 me zvogelimin e kapitalit themeltar nën vlerën e përcaktuar në këtë ligj si dhe në rastet e tjera të parashikuara nga ligji.



Neni 8

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërisë është 3 200 000 (tre milion e dyqind mijë) leke. Ky kapital është i vlefshëm për regjistrimin e shoqërisë.

Ky kapital është i ndarë në aksione me vlerë nominale 1 000 leke secili. Në këtë mënyrë kapitali themeltar i "ABISSNET" sh.a. përbehet nga 3 200 aksione të numeruara nga 1 (një) deri në 3 200 aksione përfshi dhe numrin e fundit, të zotëruara teresisht nga aksioneri i vetëm z. Koço Kokedhima.

Neni 9

NDRYSHIMET E KAPITALIT THEMELTAR

Kapitali themeltar mund të zmadhohet me të gjitha mënyrat dhe modalitetet e kërkuara nga legjislati në fuqi për këtë qëllim.

I vetmi organ kompetent për ndryshimin e kapitalit është Asambleja e Jashtëzakonshme e cila merr vendim në bazë të raportit të Drejtorisë që përmban treguesit e kërkuar nga ligji. Në përputhje me ligjin, aksionerët kanë për pjestimisht me shumën e aksioneve të tyre, një të drejtë përcësore në nënshkrimin e aksioneve të emetuara për të kryer një zmadhim të kapitalit. Ata mund të heqin dorë nga kjo të drejtë vetëm individualisht.

Me rezervën kur është rasti për të drejtat e kreditorëve, Asambleja e Jashtëzakonshme mund të autorizojë ose të vendosë zvogelimin e kapitalit për çfarëdo arsye, por në asnjë rast ky zvogelim nuk mund të cenojë barazimin ndërmjet aksionerëve.

Zvogelimi i kapitalit, për çfarëdo shkakut qoftë, në një shumë më të vogël se minimumi ligjor mund të vendoset vetëm me kushtin pezullues të një zmadhimi të kapitalit i destinuar të çojë këtë të fundit të pakten të minimumin ligjor, përveç rastit kur shoqëria transformohet në një formë tjetër shoqërie që nuk kërkon kapital më të lartë se sa ai i zvogeluar.

Në rastin e mosrespektimit të kësaj dispozite çdo i interesuar mund të kërkojë nga gjykata kompetente prishjen e shoqërisë. Prishja e shoqërisë nuk mund të shpallet nëse në ditën kur gjykata shqyrton çështjen gjendja është rregulluar.

KREU II

AKSIONET DHE AKSIONERET

Neni 10

AKSIONERET E SHOQËRISË

Aksionerët e shoqërisë janë persona fizikë dhe juridikë që kanë vënë ose do të vënë në zotërim aksione të shoqërisë me të gjitha mënyrat e parashikuara nga ligji. Zotërimi i



aksioneve te shoqerise u jep atyre te drejten te marrin pjese ne Asamble dhe ne votim. ne perpjesetim me aksionet qe zoterojne.

Neni 11

TE DREJTAT DHE DETYRAT E AKSIONEREVE

Cdo aksioner i shoqerise ka te drejten e pjesemarrjes ne fitimet e shperndashme te shoqerise ne perputhje me aksionet e tij sipas vleres nominale te zoteruar prej tij ne kapitalin e shoqerise. Cdo aksioner ka te drejte te marre, kur eshte rasti, nje teprice nga likuidimi i kapitalit ne perpjesetim me vleren e aksioneve qe zoteron.

Aksioneret kane te drejten e votes dhe te perfaqesimit ne Asmblesene e pergjithshme te aksionereve me kushtet e parashikuara nga legjislacioni ne fuqi dhe ky statut.

Votat qe zoterojne aksioneret jane proporcionale me perqindjet e aksioneve qe zoterojne.. Aksioneret e shoqerise jane vete pergjegjes per deyrimet dhe per humbjet e shoqerise deri ne kufirin e vleres nominale te aksioneve qe zoterojne. Pergjegjesia tej kesaj mase eshte e ndaluar.

Te drejtat dhe detyrimet e permendura me siper ndjekin aksionin ne cfaredo forme qe ai te tjetersohet tek te tretet.

Neni 12

FORMAT E AKSIONEVE DHE LIBRI I AKSIONEVE

Aksionet jane te formes emerore. Pronesia e aksioneve rezulton nga rregjistrimi i tyre ne emer te titullarit ose titullareve ne librin e aksioneve te mbajtura nga ana e shoqerise ose nga ndermjetesat financiare.

Libri i aksioneve do te permbaje ne cdo kohe informatat qe vijne, numrin dhe kategoria e aksioneve, daten e marrjes nga aksioneri, emrin, mbiemrin dhe adresen e cdo aksioneri si dhe vleren nominale per cdo aksion te zoteruar.

Secili aksioner ka te drejte te kerkoje me shkrim dhe te marre nje ekstrakt nga libri i aksionereve i cili vertetohet me vulen e shoqerise.

Secili aksioner ka te drejte te verifikojte nese emri i tij eshte futur ne librin e aksionereve dhe personi i cili mban librin eshte i detyruar t'i tregojte aksionerit me kerkesen e ketij te fundit, hyrjen perkatese ne liber.

Neni 13

SHITJA DHE TRANSFERIMI I AKSIONEVE

Aksionet jane lirisht te transferueshme tek te tretet, pa miratimin e shoqerise. Ne rastin e zmadhimit te kapitalit, aksionet jane lirisht te tregetueshme pas realizimit te ketij zmadhimi. Pas prishjes se shoqerise aksionet mbeten lirisht te tregetueshme deri ne mbylljen e likuidimit sipas dispozitave ne fuqi.



Ndryshimi i pronësise së aksioneve si rrjedhojë e një shitje apo e një transferimi kryhen nëpërmjet një kalimi nga llogaria e dhenesit tek llogaria e marresit në bazë të një urdhri xhirimi.

Shoqëria është e detyruar të kryejë këtë regjistrim dhe këtë xhirim brenda gjashtë ditëve nga marrja e urdher xhirimit.

Urdhri i xhirimit i përgatitur në një formular të dhënë nga shoqëria ose të miratuar nga shoqëria nënshkruhet nga dhenesi i aksionit ose përfaqësuesi i tij. Nëse aksionet nuk janë shlyer tërësisht, urdher xhirimi nënshkruhet nga marresi.

Shoqëria do të kërkojë që nënshkrimet e paleve të vertetohen nga noteri përveç rasteve kur ky vertetim është përjashtuar nga ligji.

Transferimi i aksioneve falas si rrjedhojë e tashegimnise kryhet, gjithashtu, me anë të kalimit në llogari në bazë të një dokumenti ligjor që verteton transferimin.

Shpenzimet për transferimin e aksioneve janë në ngarkim të marresit përveç rastit të një marreveshje të kundërt midis dhenesit dhe marresit. Aksionet e pashlyera për derdhjet e kerkuara nuk mund të pranohen për transferim.

Neni 14

SHLYERJA E AKSIONEVE

Aksionet e nënshkruara në para lidhur me zmadhimin e kapitalit të shoqërisë duhet të shqyrtohen sipas modaliteteve të caktuara nga Asambleja e përgjithshme e Jashtëzakonshme. Shlyerja e këtyre aksioneve nuk mund të jete me e ulët se sa në e katërta e vlerës nominale dhe nëse është rasti e teresise së primeve të aksionit.

Shlyerja e vlerës nominale të mbetur duhet të kryhet në një ose disa keste me kërkesë të Drejtorisë së Përgjithshme të shoqërisë në një afat prej 1 viti nga data kur ky zmadhim i kapitalit është bërë përfundimtar.

Për shlyerjen e aksioneve, kërkesat për fonde u behen të njohura nënshkruesve të pakten pësembedhëte ditë përpara datës së caktuar për çdo mbledhje me leter rekomande me kthim përgjigje për marrjen në dorëzim të adresuar tek çdo titullar i aksioneve.

Cdo vonesë në derdhjen e shumave të duhura nga shumat e pashlyera të aksioneve sjell pagimin e interesave me përqindjet ligjore dhe kjo pavarësisht nga veprimi personal që shoqëria mund të ushtrojë ndaj aksionereve që nuk shlyejnë detyrimin dhe nga masat e zbatimit të detyruar të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për këte problem.


KREU III

ORGANET DREJTUESË TË SHOQËRISË

Neni 15

ORGANET DREJTUESË TË SHOQËRISË

Organet drejtuese të shoqërisë janë:



1. Asambleja e pergjithshme
2. Keshilli Mbikqyres
3. Drejtoria

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

Neni 16

MBLEDHJA E ASAMBLESE

Asambleja e pergjithshme merr te gjitha vendimet te cilat jane te percaktuara nga ligji ose nga ky statut, me perjashtim te rasteve kur vendimet perfshihen ne kompetencat e Asamblese se Jashtezakonshme.

Kjo Asamble do te mbahet ne 6 muajt e pare te çdo viti fiskal. Asambleja e Jashtezakonshme do te thirret nese kjo do te konsiderohet e nevojshme dhe ne interes te shoqerise dhe nese jane plotesuar kushtet ligjore per nje mbledhje te tille.

Mbledhja e asamblese kryhet me ane te nje lajmerimi ne publikimin e autorizuar, qe permban informacionin ligjor ne menyre te tille qe te jete nje periudhe prej te pakten 15 ditesh ndermjet dites se publikimit dhe dites se fundit per depozitimin.

Neni 17

E DREJTA E VOTES

Cdo vlere nominale prej 1000 lekesh perfqson vetem nje vote. E drejta e votes mund te ushtrohet me ane te nje autorizimi per te cilin kerkohet nje forme e shkruar.

Kushtet ne baze te te cilave aksionmbajttesi mund te ushtrojne te drejten e votes ne asamble percaktohen ne ftesen per te marre pjese ne Asamblene e aksionereve per aq kohe sa nuk jane dhene çertifikatat e aksioneve.

Neni 18

KRYETARI

Mbledhjet e Asamblese se Aksionereve drejtohen nga kryetari i Keshillit Mbikqyres ose ne mungese te tij, nga personi i parashikuar ne statut; perndryshe vete Asambleja zgjedh drejtues te mbledhjes se saj.

Ne rast te thirrjes se Asamblese nga ekspertet kontabel te autorizuar, nga nje mandatmbajttes i autorizuar nga gjykata ose nga likuiduesit, mbledhja e Asamblese drejtohet nga personi ose njeri prej personave qe kane thirrur kete mbledhje.

Kryetari drejton asamblene dhe vendos mbi vazhdimesine, objektet e diskutimit dhe mbi menyren e votimit.



Neni 19

QUORUMI

Asambleja formon nje quorum nese jene perfaqsuar te pakten 25% e aksioneve me te drejte vote. Ne qofte se perfaqsimi eshte me pak se 25% thirret menjehere nje mbledhje e dyte e cila formon nje quorum pa marre parasysh perfaqsimin e aksioneve me votim nese kjo pike eshte percaktuar ne lajmerim, me perjashtim te rasteve kur per marrjet e vendimit te hartuar ne rendin e dites kerkojnet me ligj nje mazhorance me e larte.

Vendimet e asamblese merren me shumicen e thjeshte te votave me perjashtim te rasteve kur ligji e parashikon ndryshe. Ne raste te tilla kur ligji percakton mazhorance te kapitalit ne para qe shoqeria ka ne dispozicion te saj, qe ekziston ne kohen e miratimit te rezolutes, do te jete e mjaftueshme nje mazhorance e thjeshte e kapitalit themelor ekzistues nese ligji nuk parashikon nje mazhorance me te larte.

Nese mazhoranca e thjeshte nuk arrihet ne votimin e pare atehere ndermjet dy personave qe kane numrin me te madh te votave do te zhvillohet nje votim perfundimtar. Ne rastin e barazimit te votave ne balotazhin e dyte do te hidhet short.

Ne asamblene e aksionereve do te merrren aktet noteriale, te cilat do te firmosen nga noteri dhe kryetari i asamblese.

Neni 20

RRADHA E PARAQITJES SE DOKUMENTAVE

Drejtoria e shoqerise duhet t'i paraqese Keshillit Mbikqyres dokumentet ligjore ne lidhje me aktivitetin e shoqerise gjate vitit te fundit sipas kerkesave ligjore ne tre muajt e pare te cdo viti fiskal.

Bilancet financiare ne fund te vitit, raporti mbi aktivitetin, raporti i Keshillit Mbikqyres dhe te gjitha projekt-vendimet dhe dokumentet e tjera te parashikuara ne ligj duhet te paraqiten 15 dite perpara Asamblese ne seline e aktivitetit te shoqerise per tu shqyrtuar nga aksionmbajtësit ose duhet tu dergohen atyre ne baze te kerkeses se tyre.

Cdo vit pas marrjes se raportit i cili duhet t'i dorezohet Keshillit Mbikqyres brenda 6 muajve te pare te vitit ushtrimor. Asambleja vendos mbi zevendesimin e Drejtorise se shoqerise dhe Keshillit Mbikqyres mbi perfundimin e perfitimit neto te vitit dhe ne rastet e tjera te parashikuara me ligj mbi percaktimin e treguesve.

KESHILLI MBIKQYRES

Neni 21

PERBERJA



Keshilli Mbikqyres perbehet nga 3 antare. Koha e ushtrimit te detyres per te gjithë antaret eshte 4 vjet.

Antaret e Keshillit Mbikqyres mund te japin doreheqjen nga detyra me ane te nje deklarate me shkrim e cila duhet t'i dergohet kryetarit te Keshillit Mbikqyres duke respektuar nje limit kohe prej dy javesh.

Neni 22

TE DREJTAT DHE DETYRAT

Keshilli Mbikqyres kontrollon Drejtorine e shoqerise dhe eshte pergjegjes per heqjen e detyrave dhe mbrojtjen e te drejtave te cilat i kalojne me ane te ligjit, statutit ose ne ndonje forme tjeter. Keshilli Mbikqyres ka te drejten te therrese Asamblene e aksionereve

Keshilli Mbikqyres mund te percaktoje nje liste te atyre masave dhe veprimeve te cilat mund te merren nga Drejtoria e shoqerise. Keto i nenshtrohen marreveshjes fillestare te Keshillit Mbikqyres. Kjo eshte e vlefshme sidomos per politiken e objekteve te biznesit, investimit dhe financimit, fushat e veprimit te shoqerise dhe personelit dhe drejtrimin e kontrates.

Keshilli Mbikqyres ka te drejte te mbikqyre ne çdo kohe menazhimin e plote te Drejtorise se shoqerise. Ne kete menyre mund te shihen dhe inspektohen nga Keshilli Mbikqyres edhe librat, regjistrimet dhe qellimet e shoqerise.

Ky i fundit ka kompetencen te beje ndryshimet e nevojshme ne statutin e shoqerise.

Drejtoria e shoqerise eshte e detyruar te vete ne dijeni Keshillin Mbikqyres sipas menyres se percaktuar ne ligj. Pervec kesaj Keshilli Mbikqyres mund te kerkoje nje raport per problemet e shoqerise, marrdheniet ligjore dhe te biznesit me shoqerite qe ka lidhje si dhe per aktivitetet e biznesit qe jane sinjifikative per pozicionin e aksionmbajtesve.

Deklaratat e Keshillit Mbikqyres do te jepen ne emer te ketij keshilli nga kryetari dhe ne mungese te tij nga zevedeskryetari.

Gjate kryerjes se detyrave te tij, Keshilli Mbikqyres mund te vleresoje vete mb. kualifikimin e pales se trete per mbeshtetjen e tij. Gjithashtu pala e trete mund te marre pjese ne mbledhjet e Keshillit si keshillues.

Neni 23

ZGJEDHJA E KRYETARIT

Keshilli Mbikqyres zgjedh midis antareve te tij nje kryetar dhe nje zevendes per kohen e ushtrimit te detyres se percaktuar ne nenin 21 te ketij statuti. Zgjedhja e tyre behet ne mbledhjen e pare qe thirret pas Mbledhjes se Pergjithshme se aksionmbajtesve ne te cilen eshte zgjedhur ky keshill. Ne qofte se kryetari ose zevedesi i tij lirohen nga detyra para mbarimit te afatit, do te kryhet nje zgjedhje tjeter per periudhen e mbetur nga koha e ushtrimit te detyres se personave qe jane liruar. Ne pamundesi ardhjeje te kryetarit dhe zevendesit te tij gjate kesaj kohe, detyrat do te kryhen nga anetari me i vjeter ne moshe.

Keshilli Mbikqyres mund te caktoje rregulla te brendshme lidhur me proceduren e punes. Vendimet mund te nxirren vetem nga Keshilli Mbikqyres. Drejtoria e shoqerise merr pjese ne mbledhjen e Keshillit.

Neni 24

MBLEDHJET E KESHILLIT MBIKQYRES

Mbledhjet e keshillit Mbikqyres thirren me shkrim nga kryetari dhe ne pamundesi ardhjeje nga zevendesi i tij. Lajmerimi behet 15 dite perpara. Ne rast urgjence lajmerimi mund te behet brenda nje kohe me te shkurter dhe ftesa mund te komunikohet gojarisht, me telefon, teleks ose telegram. Ne kete ftese duhet te specifikohen rendi i dites dhe sugjerimet e vendimeve.

Ndonje antar i Keshillit Mbikqyres mund te shtroje çeshtje ne rendin e dites te cilat duhet t'i behen te njohura kryetarit me ane te nje letre te pakten 10 dite para mbledhjes. Te gjithë anetaret e tjere te Keshillit duhet te informohen pa vonese mbi shtesat e rendit te dites.

Neni 25

MIRATIMI

Nese te gjithë anetaret e Keshillit Mbikqyres jane te ftuar ne kohen e duhur dhe nese te pakten gjysma e numrit legal te tyre merr pjese ne miratimin e nje rezolute, atehere Keshilli Mbikqyres formon nje quorum, anetaresh qe duhet te jene prezent per te konsideruar nje mbledhje te vlefshme. Miratimi i nje rezolute e cila nuk ka qene e perfshire ne rendin e dites, eshte e lejueshme vetem nese asnje nga anetaret e pranishem te Keshillit Mbikqyres nuk e kundërshton rezoluten dhe te pakten dy te tretat e anetaresh jane te pranishem.

Mbledhja do te drejtohet nga kryetari dhe ne rast se ai nuk eshte i pranishem nga zevendesi i tij. Kryetari vendos rradhen e rendit te dites, llojin dhe rradhen e votimit.

Vendimet mund te miratohen vetem nga mbledhjet e Keshillit Mbikqyres me shumicen e thjeshte me perjashtim te rasteve kur ligji parashikon ndryshe. Kjo eshte e vlefshme dhe per votimin.

Ne rast barazimi votash do te ndermerret nje tjetër diskutim lidhur me çeshtjen konkrete vetem nese shumica e Keshillit Mbikqyres vendos per kete, perndryshe do te behet nje njoftim tjetër i menjehershëm. Nese dhe rezultati i votimit te dyte eshte i barabarte, atehere kryetari i jepet e drejta e dy votave.

Procesverbalet e mbledhjeve te Keshillit Mbikqyres dhe te komiteve nese ekzistone, duhet te pergatiten dhe te nenshkruhen nga drejtuesi perkates i mbledhjes.





Neni 26

INFORMACIONET KONFIDENCIALE

Anetaret e Keshillit Mbikqyres duhet te ruajne menyren e gjykimit dhe te veprimit ne lidhje me informacionin konfidencial dhe sekretet e shoqerise, vecanerisht ato industriale dhe te biznesit per te cilat ata jane te vetedijshem nepermjet punes se tyre. Kjo mbetet e vlefshme edhe pas largimit nga Keshilli Mbikqyres. Informacioni lidhur me shoqerine mund tu transferohet te treteve vetem me miratimin e kryetarit te Keshillit dhe me kusht qe transferimi nuk rrezikon interesat e shoqerise..

DREJTORIA E SHOQERISE

Neni 27

PERBERJA

Drejtoria e shoqerise mund te perbehet nga nje ose disa persona fizike. Lejohet emerimi i anetareve zevendes te Drejtorise se shoqerise. Ata kane te drejta te njejta sikurse anetaret e tjere te Drejtorise persa i perket formes se jashtme te perfaqsimi.

Do te kryhen nga Keshilli Mbikqyres:

- Percaktimi i numrit te anetareve te Drejtorise se shoqerise (bordi drejtues)
- Perfundimi i kontratave te punesimit
- Revokumi i emerimeve
- Emerimi i nje anetari si Drejtor i Pergjithshem i Drejtorise
- Emerimi i nje zevendesdrejtori te Drejtorise nese Drejtoria perbehet nga disa anetare.

Neni 28

VOTIMI

Nese bordi drejtues perbehet nga disa persona do te percaktohen rregullat e perhershme te cilat do ti nenshtrohen miratimit te Keshillit Mbikqyres.

Vendimet e Drejtorise do te miratohen me shumice votash. Ne rast barazie votash, vota e kryetarit te Drejtorise do te jete percaktuese. Nese ai nuk eshte i pranishem atehere vota e zevendesit te tij mbetet deçizive.



Neni 29

DETYRAT E DREJTORISE

Drejtoria e shoqerise eshte e detyruar para shoqerise te respektoje kufizimet e percaktuara me ligj, statut dhe ngra Keshilli Mbikqytres lidhur me hapesiren e autoritetit te tij drejtues.

KREU IV

NDARJA, BASHKIMI DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE

Neni 30

NDARJA DHE BASHKIMI

Shoqeria mund te ndahet ose te bashkohet me shoqeri te tjera me vendim te Asamblese se Jashtezakonshme me shumicen e votave te aksionereve te caktuara per ndryshimit e statutit te shoqerise.

Ne rastin e ndarjes, bashkimit te shoqerise do te zbatohen dispozitat e seksionit IV te ligjit Nr. 7638 date 19/11/1992 "Per Shoqerite Tregtare".

Neni 31

LIKUIDIMI

Likuidim: i shoqerise vendoset nga Asambleja e Jashtezakonshme e aksionereve kur per kete jane dakort shumica e quorumit per marrjen e vendimeve ne kete Asamble.

Vendimi i likuidimit te shoqerise duhet tu behet i njohur te gjithë aksionistëve te shoqerise nepermjet publikimit te tij ne mjetet e informacionit publik. Aksioneret te cilet zoterojne aksione ne masen e parashikuar ne nenin 139 te ligjit Nr. 7638 date 19/11/1992 kane te drejte te kundershtojne ne rruge gjyqsore vendimin e marre nga Asambleja e Jashtezakonshme.

Procesi i likuidimit te shoqerise do te behet ne perputhje me dispozitat e seksionit V te ligjit Nr. 7638 date 19/11/1992 "Per Shoqerite Tregtare"

Neni 32

VULA E SHOQERISE

Vula e shoqerise ka forme drejtkendeshe ne te cilen eshte shkruar: ABISSNET-ISP T.e.J. 560-01, Rr. Vaso Pasha Tirane.



DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 33

Per çeshtjet qe nuk parashikohen dhe rregullohen nga ky statut vlejne dispozitat e ligjit Nr. 7638 date 19/11/1992 "Per Shoqerite Tregetare" si dhe aktet e tjera ligjore qe rregullojne kete veprimtari.

AKSIONERI I VETEM

Koço Kokedhima

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. 118 Rep.

Nr. 19 Kol.

VERTETIM

Ne Tirane, sot me date 29/10/1999, ne zyren e noterise Tirane, para meje Noteres Aferdita Haxhia me adrese ne rrugen " Zhan D'Ark", prane Gjykates se Rrethit Tirane, u paraqit personalisht z.Koco Kokedhima i biri i Theodhoriut, i datelindjes 21.04.1959 me banim ne Tirane, me shtetesi dhe kombesi shqiptare, me pasaporte Nr.0183354, madhor. me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i cili nenshkroi me vullnetin e tij te lire dhe te plote Statutin e Shoqerise Anonime "ABISSNET" sh.a. dhe une noterja vertetoj nenshkrimin e tij rregullisht sipas ligjit.

NOTERE

PULLE TAKSE

